



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË

Nr. 370/prot.

Tiranë, më 20.02.2024

Lënda: Mbi delegim Ankesën –

Në përgjigje të çështjes Nr. 555872, deleguar nga ana Juaj, më datë 16.02.2024 “Delegim Ankesë protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) me Nr. 370 prot, datë 16.02.2024, Ju bëjmë me dije si më poshtë.

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr.126, datë 15.10.2020 “Për Metrologjinë”, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) nuk ka detyrë dhe kompetencë verifikimin e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, shpërndarës karburanti (distributor), si dhe nuk ka asnjë të drejtë ligjore mbi këto instrumente, për rrjedhojë nuk ka kompetencë për trajtimin shterues të ankesës së deleguar.

Shërbimi i verifikimit të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, shpërndarës karburanti (distributor), kryhet nga kompani koncesionare dhe ankesat për këtë tip instrumenti matës trajtohen nga Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT).

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Petrit Rama**

